



Endri Madhi, MSc

Lektor

**Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë
Tirana Business University College**

Endri Madhi, MSc, është shembull i një karriere të ndërtuar me përkushtim dhe profesionalizëm në fushën e kontabilitetit dhe auditimit.

Ai ka përfunduar Masterin Shkencor në Kontabilitet dhe Auditim dhe numëron mbi 12 vite përvojë në sektorin privat, duke kontribuar në industri të ndryshme si shërbime konsulence dhe financiare, sektori bankar, menaxhim investimesh dhe industria minerare.

Gjatë karrierës së tij, Endri ka zhvilluar një karrierë akademike mbi 10-vjeçare si lektor në lëndët e kontabilitetit dhe auditimit në universitete publike dhe private. Në vitet e fundit, ai ka mbajtur disa pozicione menaxheriale brenda Grupit Balfin, ku aktualisht drejton Departamentin e Auditit të Brendshëm.

Ai është i pajisur me certifikime prestigjioze profesionale si FCCA, Auditues Ligjor (AL) dhe Kontabilist i Miratuar (KM), dhe tani i bashkohet stafit akademik të Tirana Business University College, si pjesë e Departamentit të Biznesit dhe Financës.

Me përvojën e tij të gjerë, Endri synon të frymëzojë studentët dhe t'i ndihmojë të lidhin teorinë me praktikën reale të biznesit dhe financës.